

Znj. Iris Aliaj

Propozuar nga Qendra për Drejtësi Gjinore

Znj. Iris Aliaj ka përfunduar studimet e larta, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe ka rritur kapacitetet e saj profesionale në një sërë shkollash dhe kursesh ndërkombëtare me fokus të drejtat e njeriut. Znj. Aliaj është themeluese e Studio Ligjore Aliaj dhe ka ushtruar profesionin e avokatit që prej vitit 2008. Ajo ka shërbyer si këshilltare e Ministrit të Drejtësisë në Shqipëri dhe ka kontribuar për një periudhë dy vjeçare në avancimin e politikave për çështje që lidhen me reformën në drejtësi, drejtësinë penale për të mitur, aksesin në drejtësi, profesionet e lira etj. Gjatë kësaj periudhe ka qenë anëtare e Komitetit Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe anëtare e Këshillit të Përmbarrimit, Përmbarrimi Gjyqësor Shtetëror.

Për më shumë se 14 vite, znj. Aliaj punon me organizata të shoqërisë civile për të garantuar aksesin në drejtësi dhe edukimin ligjor të grave viktime të dhunës me bazë gjinore, gratë e zonave rurale, personave me aftësi të kufizuara dhe komunitetit rom dhe egjiptian.

Ndër të tjera, ajo ka shërbyer si Drejtore Ekzekutive e Rrjetit Ballkanik të Shtetit të së Drejtës, (BRRLN), dhe ka punuar për American Bar Association Rule of Law Initiative (ABAROLI). BRRLN ka pasur në përbërjen e tij Dhomat Kombëtare të Avokatisë në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoninë e Veriut si dhe organizata të shoqërisë civile të drejtësisë dhe medie. Në cilësinë e Drejtores Ekzekutive ka kontribuar në misionin e organizatës me qëllim sundimin e ligjit, demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, znj. Aliaj ka kontribuar për më shumë se një dekadë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, ku ka avokuar për rritjen e aksesit në drejtësi për gratë e marginalizuara dhe të abuzuara. Ajo ka ofruar ndihmë juridike falas për deri në 15 viktime të dhunës me bazë gjinore në ditë dhe ka luajtur një rol thelbësor në ndjekjen penale të rastit të parë të trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, duke siguruar dëmshpërblim për viktimën. Kontributet e saj shkojnë përtej praktikës ligjore, pasi ajo ka qenë e përfshirë në kërkime, raporte monitorimi dhe trajnime që kanë për qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Ajo ka punuar për të ndërmarrë dhe mbështetur iniciativa për përmirësimin e legjislacionit dhe lobimin për projekt-ligje dhe politika shtetërore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke u përqëndruar në barazinë gjinore, diskriminimin, luftën kundër dhunës me bazë gjinore, luftën kundër korrupsionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë gjithë karrierës së saj, ajo ka qenë një kampione e të drejtave të njeriut, duke synuar përmirësimin e ligjeve dhe politikave shtetërore për të mbrojtur më mirë popullsinë e cënueshme.

Mrs. Iris Aliaj

Proposed by the Center for Gender Justice

Mrs. Iris Aliaj completed her higher education at the Faculty of Law, University of Tirana, and has further enhanced her professional capacities through various international programs and courses, specializing in multiple areas of law with a focus on human rights. Mrs. Aliaj is the founder of Studio Ligjore Aliaj and has been practicing law since 2008. Her extensive legal experience includes serving as an advisor to the Minister of Justice in Albania, where she focused on key areas such as justice reform, juvenile justice, mediation, legal professions, and access to justice through state-guaranteed legal aid.

For over 14 years, Mrs. Aliaj has been working with civil society organizations to ensure access to justice for women, persons with disabilities, the Roma and Egyptian communities, and women from rural areas. Notably, she served as Executive Director of the Balkans Regional Rule of Law Network (BRRLN), where she contributed to strengthening independent defense bar associations and promoting the rule of law, democracy, and human rights throughout the region.

Mrs. Aliaj has also dedicated more than a decade to human rights work at the Center for Legal Civic Initiatives in Albania, where she advocated for increased access to justice for marginalized and abused women. She provided free legal aid to up to 15 victims of domestic violence daily and played a crucial role in prosecuting Albania's first human trafficking case, securing compensation for the victim. Her contributions extend beyond legal practice, as she has been involved in research, monitoring, and training aimed at improving the justice system in Albania.

Her work in legislative reform and policy advocacy has focused on advancing gender equality, anti-discrimination, combating domestic violence, and addressing corruption and human trafficking. Throughout her career, she has consistently championed human rights, striving to improve laws and state policies to better protect vulnerable populations.